

**UDHËZIM****Nr. 421, datë 22.1.2016****PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 15, DATË 24.7.2007, “PËR KRITERET DHE PROCEDURAT E LËSHIMIT TË LICENCAVE, AUTORIZIMEVE DHE CERTIFIKATAVE PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË NË TRANSPORTIN RRUGOR”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës, ligjit nr. 115/2014, “Për ndarjen administrative-territoriale të njërive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë” dhe me qëllim rregullimin, disiplinimin dhe monitorimin e veprimtarisë së ushtuar ose që kërkohet të ushtrohet nga personat fizikë apo juridikë në fushën e transportit rrugor, si dhe integrimin e plotë të tyre në tregun evropian të transportit rrugor, ministri i Transportit dhe Infrastruktūrës,

UDHËZON:

Në udhëzimin nr. 15, datë 24.7.2007, “Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të licencave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor, të ndryshuar”, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Kudo në udhëzim, fjalët “... komunë ...”, “... ose komunal ...” dhe “i komunës...”, shfuqizohen.

Neni 2

Në kreun IV, “Funksionimi i strukturave për dhënien e licencave/autorizimeve/certifikatave”, neni 12, “Dorëzimi dhe pranimi i kërkesave”, paragrafi i parë dhe i dytë, i pikës 4, ndryshojnë si vijon:

“4. Lejet e transportit (autorizimet), lejet e operimit (autorizimet) në transportin ndërkombëtar të udhëtarëve dhe mallrave dhe certifikatat e automjeteve, që shoqërojnë këto leje, nënshkruhen nga ministri ose nga personat e autorizuar prej tij.

Certifikatat e automjeteve për shërbimet e tjera të transportit, të ndryshme nga ato të përmendura në paragrafin e parë, nënshkruhen nga drejtori që mbulon veprimtarinë e transportit në DPSHTRR dhe Bashki”.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I TRANSPORTIT
DHE INFRASTRUKTURËS
Edmond Haxhinasto

URDHËR**Nr. 951, datë 3.2.2016****PËR DELEGIM KOMPETENCE**

Në mbështetje të nenit 102, të pikës 4, të Kushtetutës, nenit 7, pikës 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar, të nenit 27, të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Drejtësisë nga data 4.2.2016 deri në datën 7.2.2016, zëvendësministrit të Drejtësisë z. Arben Isaraj.

2. Ngarkohet zëvendësministri, z. Arben Isaraj, për zbatimin e këtij urdhri.

3. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I DREJTËSISË
Ylli Manjani

VENDIM**Nr. 13, datë 3.2.2016****PËR MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË RREGULLOREN “PËR LICENCIMIN, RREGULLIMIN DHE MBIKËQYRJEN E OPERATORËVE TË SKEMAVE KOMBËTARE TË PAGESAVE ME KARTË**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 43, shkronja “c”, si dhe nenit 53, pika 4, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar; dhe me propozimin e Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë dhe të Departamentit të Sistemeve të Pagesave, Kontabilitetit dhe Financës, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,